

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË
Tika Studios SHPK

THEMELIMI

Neni 1
Ortaket themelues

1.1 Shoqëria Tika Studios SHPK themelohet nga Ortaket

Z. Ronaldo Cala shtetas shqiptar, lindur me 28.08,1998 ne Cerrik , banues ne Rruga Mihal Grameno, Nd.I, Shk,4, Ap.20, Tirane ,mbajtes i Kartes se Identitetit me nr. J80828009A.

Z. Vangjush Premti, shtetas shqiptar, lindur me 25.04.1998 ne Korce , banues ne Rruga Hamdi Garunja, Nd.8, Shk.5, Ap.17, Tirane ,mbajtes i Kartes se Identitetit me nr. J80425090K.

Z. Armand Brahaj, shtetas gjerman, lindur më 06.09.1979, ne Rubik, Rreshen, banues ne Rruga Shemsi Haka, Nr 73/1, Tirane, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr. L8RY7VF24.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2
Emërtimi

2.1 Emërtimi i shoqërisë është Tika Studios sh.p.k

Neni 3
Forma ligjore



3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4 Baza ligjore

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5 Kohëzgjatja e veprimtarisë

5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit

5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është për një afat të papercaktuar.

Neni 6 Selia

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Asim Vokshi, Nr 13, Tirane.

6.2 Administratori i shoqërisë mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund të crregjistrojë ato ekzistuese sipas ligjeve në fuqi.

6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me vendim të Administratorit të shoqërisë.

Neni 7 Emblema. Vula



- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj.

Neni 8 Objekti

- 8.1 Objekti veprimtarisë së Shoqërisë është: Zhvî//ime software .
- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Administratorit.

Neni 9 Kapitali

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (njqind mije) Leke i ndare ne 3 Kuota
- 9.2 Ortaku Ronaldo Cala zoteron 1 (një) kuote me vlere 33%, e cila eshte e barabarte me vleren e kapitalit prej 33000 Lekesh .
- Ortaku Vangjush Premti zoteron 1 (një) kuote me vlere 33%, e cila eshte e barabarte me vleren e kapitalit prej 33000 Lekesh .
- Ortaku Armand Brahaj zoteron 1 (një) kuotë me vlere 34%, e cila eshte e barabarta me vleren e kapitalit prej 34000 Lekesh .
- 9.3 Ka pitali është shlyer tërësisht,

Neni 10 Transferimi i kuotave. Kufizimet.

- 10.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 '(Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese duke marrë miratimin paraprak të ortakëve.

A.B.



10.2 Vendorsja e Gfarädolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Ortakeve .

Neni 11 Rritja e kapitalit

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim unanim të Ortakeve.
11,2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakët të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të unanim te Ortakeve.

Neni 12 Zvogëlimi i kapitalit

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga ortakët e shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin ortakut të vetëm raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
12,3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim unanim te Ortakeve

ORGANET E SHOQËRISE

Neni 13 Vendimet e ortakut të vetëm

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Ortaket me arritjen e një kuote prej 75 % te totalit.
13.2 Vendimet e Ortakut përfshijnë kryesisht:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta; ▪ Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;



- Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursës së veprimtarisë;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqërisë në formë të tjera.

Neni 14 Administrimi

14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator që caktohet me vendim të Ortakëve,

14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakëve.

Administratori i shoqërisë është Z.Vangjush Premti, shtetas shqiptar Lindur me 25104,1998 në Korce, Banues në Rruga Hamdi Garunja, Nd,8§ Shk.51 Ap.171 Tirane, mbajtes i Kartes së Identitetit me nr. J80425090K1

14.3 Administratori është përgjegjës për veprimtarinë e mëposhtme:

- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
- Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
- Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatimin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursës së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron; ▪ Të zhvillojë veprimtari të tjera të Gdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitucione apo entitete publike ose private;
- Të lidhë për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
- Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit në Shqipëri;
- Të vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë;

A.B.



- Té përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
- Të ndërmarrë Gdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm Për biznesin e shoqërisë në Shqipëri.

14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm Për 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje Ose deri në gatin e revokimit të tij me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 15

Viti financiar

15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.

15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16

Bilanci. Kontabiliteti.



16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga ortakët dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm,

A.B.

Neni 17
Te Ardhurat. Dividendi

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr, 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund t'i kalojnë ortakeve sipas kuotave perkatëse .
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortakët do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18
Likuidimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset nga ortakët .
- 18.2 Me vendimin e Ortakeve caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, ortakët do të shqyrtojnë bilancin përfundimtar dhe do të miratojnë përfundimin e procedurave të likuidimit.

Neni 19
Mosmarrëveshjet

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.


Neni 20



Klauzolë mbyllëse

20.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë, datë 22/08/2024.

ARMAND BRANA


Ronaldo Çelo


Vangjush Premti
